

VENDIM
Nr.10, datë 15.3.2010

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA
UJËSJELLËS SKRAPAR

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 " Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura ", i ndryshuar, si dhe metodikës "Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik ", në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU- së

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për sh.a. ujësjellës Skrapar, si më poshtë:

Për ujin e pijshëm:

-Konsumator familjar:	27 lekë/m ³
-Institucione buxhetore:	80 lekë/ m ³
-Ente private:	95 lekë/ m ³

2. Pagesa rregullatore për sh.a. ujësjellës Skrapar do të jetë 0.8 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.03.2010 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI I ERRU
Avni Dervishi